



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-244-183 • www.uni-pr.edu

Ref. nr. 2172 Prishtinë, Dt. 05/07/2025

**RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER**

FAKULTETI	I Shkencave Matematike Natyrore
Departamenti/ Programi	Master i Gjeografisë
Projektpropozimi	<i>GIS në analizën e shfrytëzimit të tokës në qytetin e Mitrovicës nga viti 2000-2018</i>
Kandidati	Faton Beqiri
Mentori	Prof.Ass.Dr.Fitim Humolli
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë:28.02.2025 Vendimi nr.:687

ANALIZA E DORËSHKRIMIT

Punimi kishte për synim që të nxjerrë rezultate për ndryshimin e përdorimit të tokës në qytetin e Mitrovicës në një periudhë kohore 18 vjeçare dhe atë prej vitit 2000 deri në vitin 2018. Komuna e Mitrovicës ka 46 vendbanime kurse në këtë punim është analizuar zonën e qytetit të Mitrovicës. Që të konstatohet ndryshimi i shfrytëzimit të tokës urbane kandidati ka shfrytëzuar Corine Land Cover. Gjatë analizës kandidati ka konstatuar se në vitin 2000 ishin gjithsej 3 kategori të rendit të parë, 8 nën kategori të rendit të dytë si dhe 9 nënkategori të rendit të tretë. Kjo zonë e studimit ka 978.245 Ha sipërfaqe dhe secila prej këtyre kategorive kanë zënë një sipërfaqe të caktuar e që ka ndryshime mes periudhës analize.

Pas analizave kandidati ka konstatuar se kategoria e cila zë vend më së shumti në hapësirën e studimit(Harta) është “Strukturë urbane e ndërprerë” me 60.16%, pastaj “Toka pjesërisht me kultura bujqësore, me vegjetacion natyror” me 12.4%, pastaj “Tokë e punueshme e pa ujitur” me 8.64%, “Kullotat” 6.26%, “Hapësira për sport dhe rekreacion” 4.2%, “Pyjet gjethegjërë” 4.12%, “Modele komplekse të kulturës” 2.39%, “Industria ose Tregtia” 0.97% dhe “Deponi” 0.80%(Tab.).

Duke analizuar në aspektin kohor kandidati konstaton se në Viti 2018 manifestohet me më shumë ndryshime se viti 2000. Nga analizat e bëra mund të thuhet se ndryshimet kanë ndodhur në secilën kategori duke përfshirë rritjen apo edhe zvogëlimin e sipërfaqeve të kategorive të ndryshme ndër vite. Në vitin 2018 kategoria “Strukturë urbane e ndërprerë” zë 64.97%, pra njëjtë sikurse në vitin 2000 ku kjo kategori zë sipërfaqen më të madhe, pastaj “Toka pjesërisht me kultura bujqësore, me vegjetacion natyror” zë 10.6%, “Tokë e punueshme e pa ujitur” zë 12.49%, “Kullotat” zënë 3.63%, “Hapësira për sport dhe rekreacion” zhduket totalisht, “Pyjet gjethegjërë” zënë 4.31%, “Modele komplekse të kulturës” 3.20%, “Industria ose Tregtia” 0.00026% si dhe “Deponi” 2.03%.

Nga pjesa hartografike e punuar me analizën e të dhënave hapësinore dhe gjeomatike kandidati ka

konstatuar ndryshimin e kategorive të ndryshme çoftë për anën negative dhe ata pozitive. Kategoritë të cilat e kanë rritur sipërfaqen e tyre që nga viti 2000 deri në vitin 2018 janë: “Strukturë urbane e ndërprerë”, “Deponi”, “Tokë e punueshme e pa ujitur”, “Modele komplekse të kulturës” dhe “Pyjet gjethegjërë”, kurse sipërfaqet e zvogëluara janë: “Industria ose Tregtia”, “Hapësira për sport dhe rekreacion”, “Kullotat” si dhe “Toka pjesërisht me kultura bujqësore, me vegetacion natyror”.

Analiza e ndryshimit të secilës kategori të shfrytëzimit të tokës për këto 18 vite jep rezultate interesante që mund të ofrojnë të dhëna të vlefshme për studime të mëtejshme si dhe pasqyrën e ndryshimit të qytetit në përgjithësi.

Rezultatet nga dhënat konstatojnë ndryshimet e shumta për secilën kategori, ku mund të vërehet se kategoria e cila ka ndryshuar më së shumti është kategoria me kodin 142 e cila ka zënë 4.20% të hapësirës në përgjithësi, kurse në vitin 2018, kjo kategori nuk ekziston, ndërsa kategoria 132 është rritur për 97.85%, nga 0.80% në 2.30% të sipërfaqes së përgjithshme.

Rezultatet e arritura në këtë studim lidhur me ndryshimin e mënyrës së shfrytëzimit të tokës kandidati i ka ilustruar mjaft mirë përmes hartave, grafikeve dhe tabelave.




Analiza hapësinore dhe paraqitja hartografike ka mundësuar nxjerrjen e përfundimeve të ndryshimeve dhe shtrirjes hapësinore të ndryshimeve në shfrytëzimin e tokave. Duke analizuar këto mund konstatohet zgjerimi i kategorisë “Strukturë urbane e ndërprerë” e cila është zgjeruar në pjesën veri-lindore të qytetit në dëm të kategorisë “Toka pjesërisht me kultura bujqësore, me vegetacion natyror”, në pjesën jugore në dëm të kategorive “Toka pjesërisht me kultura bujqësore, me vegetacion natyror”, “Modelet komplekse të kulturës” dhe “Kullotat” dhe në lindje një pjesë e vogël në dëm të kategorisë “Modelet komplekse të kulturës”. Ndryshim tjetër mund të hasen edhe te kategoritë e tjera siç janë: kategoria “Industria ose Tregtia” është zënë nga kategoria “Pyjet gjethegjërë”. ndryshimin drastik të kategorisë “Hapësirat për sport dhe rekreacion” e cila është zhdukur plotësisht dhe është zënë nga kategoria “Tokë e punueshme e pa ujitur” që ndodhet në qendër të qytetit. Në fund kategoria “Tokë e punueshme e pa ujitur” ka ndryshuar në dëm të kategorisë “Toka pjesërisht me kultura bujqësore, me vegetacion natyror” e ndodhur në jug të qytetit të Mitrovicës.

Në këtë hulumtim kandidati ka shfrytëzuar klasifikimin sipas Land Use, kategoritë e prezantuara nga Copernicus Global Land Service. Në këtë punim janë përdorur 9 kategori të rendit të III-të cilat janë prezentë në hapësirën e studiuës dhe atë kryesisht zona të përziera, çoftë urbane(industri, tregti, deponi, hapësira për sport e rekreacion) e cila zënë hapësirën më të madhe duke vazhduar deri tek hapësirat e tjera natyrore si kullotat, pyjet, livadhe etj.

Në fund mund të konstatohet se kandidati duke përdorur aplikacionet e GIS-it, produktet e platformave të Remote sensingut, modelimin dhe metodologjinë adekuate hulumtuës, ka arritur që të realizoj me sukses punën e tij hulumtuës dhe të vërtetoj hipotezën se me kalimin e kohës janë zhvilluar ndryshime të mëdha në shfrytëzimin dhe mbulueshmërin e tokës në qytetin e Mitrovicës.

Prishtinë, 03.07.2025

Komisioni:

1. 
/Prof. Dr. Florim Isufi kryetar/
2. 
/Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli— anëtar (mentor)/
3. 
/Prof. Asoc. Dr. Shpejtim Bulliqi,— anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.